



Bazat e Gjykatës së Emigracionit

Albanian | Shqip

Në **gjykatën e emigracionit**, do të keni mundësinë të mbronni çështjen tuaj përpara një gjykatësi të emigracionit dhe të tregoni arsyen se përse duhet të lejoheni që të qëndroni në Shtetet e Bashkuara. Nëse e humbisni çështjen në gjykatën e emigracionit, mund të bëni një apelim.

Ju mund të deportoheni nëse:

- humbisni në gjykatën e emigracionit dhe nuk apeloni,
- apeloni dhe humbisni.

Kush do të jetë në gjykatën e emigracionit?



- Do të jetë një **Gjykatës Emigracioni**, i cili do të vendosë nëse do të lejoheni të qëndroni në Shtetet e Bashkuara.
- Do të jetë **një avokat**, i cili punon për qeverinë. Detyra e tyre është të përfaqësojnë qeverinë e Shteteve të Bashkuara. Ata nuk punojnë për ju.
- **Nëse keni një avokat**, atij i lejohet gjithmonë që të jetë në sallën e gjyqit bashkë me ju. Gjithashtu, mund t'ju telefonojë dhe vizitojë.

Mos harroni: Qeveria nuk ju siguron një avokat, por ju mund të punësoni një avokat për t'ju përfaqësuar në gjykatë.

Kontrolli i datës së gjyqit për emigracionin

- Për të kontrolluar datën e gjyqit tuaj, do t'ju duhet numri juaj që fillon me A. (Shembull: A 000-000-000). Ky numër caktohet nga qeveria dhe shfaqet në dokumentet e emigracionit.
- Kontrolloni informacionin për seancën tuaj dëgjimore duke përdorur sistemin e Informacionit të Automatizuar për Çështjen (Automated Case Information). Më poshtë gjeni dy mënyra:
 - Telefononi linjën telefonike në numrin 1-800-898-7180. Shkruani numrin që fillon me A dhe ndiqni udhëzimet e operatorit.
 - Vizitoni faqen e internetit: <https://acis.eoir.justice.gov/en/>. Shkruani numrin që fillon me A në kutinë e kërkimit dhe klikoni "Enter" (Dërgo).



Bazat e Gjykatës së Emigracionit

Albanian | Shqip

Ndryshimi i seancës dëgjimore me prezencë fizike në një seancë dëgjimore virtuale/telefonike

Nëse dëshironi të ndryshoni seancën tuaj dëgjimore me prezencë fizike pranë gjykatës së emigracionit në një format online ose telefonik, duhet t'i dërgoni një kërkesë zyrtare gjykatës. Është e rëndësishme që kërkesën ta dërgoni sa më parë, përpara datës së seancës së radhës dëgjimore të planifikuar. Nëse veproni kështu, mos harroni të **konsultoheni me një avokat.**



- Këshillimi ligjor duhet të bëhet nga një avokat, i cili mund të ndihmojë me përgatitjen dhe dorëzimin e saktë të dokumentacionit të nevojshëm.
- Duhet t'i dërgoni gjykatës një kërkesë për të ndryshuar formatin e seancës dëgjimore (Motion to Change Hearing Format). Gjykatësi i emigracionit do të shqyrtojë kërkesën dhe do t'ju njoftojë ju ose avokatin tuaj për vendimin.
- Nëse kërkesa miratohet, seanca dëgjimore do të zhvillohet online; nëse refuzohet, seanca dëgjimore do të vazhdojë të zhvillohet me prezencë fizike.

Gjetja e përfaqësimit ligjor

Gjatë muajve të fundit, është raportuar se gjykatat e emigracionit kanë vepruar për zbatimin e masave kundër emigracionit. Duhet të keni menduar për një plan në rast se ndaloheni. Nëse keni pyetje, flisni me një avokat.

Për ndihmë ligjore falas dhe konfidenciale për emigracionin, telefononi linjën telefonike të mbështetjes ligjore për emigracionin, MOIA (Mayor's Office of Immigrant Affairs, MOIA):



1-800-354-0365

E hënë-e premte, 9:00-18:00

Disponohet shërbimi i përkthimit

Çdo gjykatë emigracioni ka një listë të ofruesve të shërbimeve ligjore për emigracionin falas ose me pagesë të ulët, të cilët ndodhen pranë saj.

Skani kodin QR për të parë paraprakisht listën e organizatave ligjore për emigracionin, që ofrojnë shërbime falas pranë gjykatës suaj, ose vizitoni: www.justice.gov/eoir/list-pro-bono-legal-service-providers



Kjo broshurë jep vetëm informacione të përgjithshme. Nuk është këshillim ligjor. Për këshillim ligjor, konsultoni një avokat.